

1) Në një kuti ka 4 zara të bardhë, 3 zara të verdhë dhe 7 zara jeshilë. Sa është probabiliteti që të nxjerrim nga kutia në mënyrë rastësore, një zar të bardhë ose një zar jeshil?

A) $1 / 14$

B) $1 / 2$

C) $11 / 14$

D) $4 / 14$

2) Identifiko fjalën për t'u eliminuar si jokoherente me të tjerat:

A) Gjarpër

B) Balenë

C) Lepur

D) Lakuriq nate

3) Përzgjidhni alternativën, e cila përshkruan më mirë funksionin e objektit të ilustruar më poshtë:



A) Banesë kolektive

B) Opera

C) Pallat sporti

D) Muze

4) Një djalë me motor ndjek shokun, i cili është me biçikletë. Pas sa kohe takohen, nëse shpejtësia e dy mjeteve është respektivisht 40km/h dhe 20km/h dhe në çastin e dhënë janë 500m larg njëri tjetrit?



A) 3 minuta

B) 90 sekonda

C) 60 sekonda


D) 1 orë

5) Cila nga paraqitjet është projeksioni i saktë në horizontal i trupit të prerë me dy plane?




1

A) 1




2

B) 4



3


C) 3



4


D) 2

- 6) Kush është krijuesi i “Modulorit”, sistemit universal të matjes i cili bazohet në proporcionet e trupit të njeriut?
- A) Frank O. Gehry
B) Ludwig Mies van der Rohe
C) Frank Lloyd Wright
D) Le Corbusier
- 7) Cili nga vendet e mëposhtme nuk bën pjesë në zonën Shengen?
- A) Islanda
B) Finlanda
C) Zvicra
D) Mbretëria e Bashkuar
- 8) Cili kryeqytet europian nuk u pushtua nga nazistët gjatë Luftës së Dytë Botërore?
- A) Parisi
B) Roma
C) Praga
D) Moska
- 9) Në figurë paraqitet rruga që nisim për t'i brendashkruar rrethit:



- A) Dhjetëkëndorin
B) Shtatëkëndorin
C) Gjashtëkëndorin
D) Pesëkëndorin
- 10) Në shkallën 5:1, në cilën përmasë do të vizatohej segmenti 2 cm?
- A) 0.4 m
B) 1 m
C) 2.5 cm
D) 10 cm
- 11) Cili është autori i romanit “Harku i Triumfit”?
- A) Erich Maria Remark
B) Stefan Zweig
C) Ismail Kadare
D) Mark Twain
- 12) Në fletët e vizatimit teknik të një objekti apo detaji vendoset si rregull shkalla e vizatimit. Kur ajo është shënuar 2:1, tregon:
- A) Shkallë zvogëlimi.
B) Shkallë natyrale.
C) Shkallë kopjimi.
D) Shkallë zmadhimi.

13) Imazhi më poshtë ilustron:




- A) Asnjë nga alternativat më sipër
- C) Një zigurat

- B) Një piramidë
- D) Një obelisk


14) Merret një copë letër dhe paloset më dysh për tre herë rradhazi dhe pastaj i bëhet një vrimë në mes me majën e një lapsi. Kur e hapim letrën, sa vrima do të jenë në të?

- A) 1
- B) 6
- C) 3
- D) 8


15) Cili prej trupave në aksonometri korrespondon me paraqitjen në dy projeksione në V dhe H ?




A) 4



B) 2








C) 1




D) 3

16) Cila është kutia që mungon?



17) Sa është kuota horizontale në sheshpushim në planimetrinë e dhënë të shkallëve ?



A) +1.87 m

B) +5.02m

C) -1.53 m

D) +5.27 m

18) Cila nga urat e mëposhtme nuk i përket ndërtimeve të mesjetës?

A) Ura e Golikut, Pogradec

B) Ura e Mesit, Shkodër

C) Ura e Zogut, Milot

D) Ura e Bratajt, Vlorë

19) Katedralja “Notre Dame” në Paris është e stilit:

A) Gotik

B) Romanik

C) Të rilindjes

D) Barok



20) Kush nga arkitektët e mëposhtëm është i njohur për realizimin e veprës “Shtëpia në kaskadë”, ilustruar më poshtë?




- A) Alvar Alto
- C) Le Corbusier

- B) Walter Gropius
- D) Frank Lloyd Wright


21) Në figurë paraqitet rrafshi në aksonometri. Cila nga alternativat e dhëna paraqet projeksionet e sakta të tij?




A) 3



B) 1




C) 2



D) 4

22) Sa është lartësia e një këmbë shkalle në prerjen e dhënë, kur lartësia e katit është 3.24m ?








- A) 17 cm B) 18.5 cm C) 18 cm D) 17.5 cm

23) Tapeti i një dhome është i ngjyrosur në këtë mënyrë: 1/3 është me ngjyrë të zezë, 1/4 me ngjyrë të kuqe, ndërsa pjesa tjetër me ngjyrë të bardhë përbën 8 metra katrorë. Sa është sipërfaqja e tapetit nëse e shënojmë me X?

- A) $X=8 \text{ metra}^2$ B) $X=96/5 \text{ metra}^2$ C) $X=5/12 \text{ metra}^2$ D) $X= 96 \text{ metra}^2$

24) Lidhni paraqitjen me projeksione me paraqitjen aksonometrike përkatëse të trupit gjeometrik.





- A) 5B, 6E, 3D, 4C, 1F, 2A
C) 4C, 5E, 6F, 1D, 2B, 3A

- B) 3B, 4A, 5E, 6F, 1C, 2D
D) 2C, 3F, 4D, 5E, 6A, 1B


25) Për cilin nga zhanret e pikturës njihet më shumë artisti i njohur shqiptar Vangjush Mio?

- A) Peizazhin B) Natyrën e qetë C) Figurat nudo D) Portretin

26) Cila është kutia që mungon?



27) Sa trekëndësha mund të numëroni në figurë?



- A) 24 B) 33 C) 12 D) 32

28) Një litër lëng në temperaturën 10°C përzihet me gjysmë litri të të njëjtit lëng me temperaturë 40°C . Temperatura e ekuilibrit është:

- A) 25°C B) 30°C C) 40°C D) 20°C

29) Një kuti është e ndarë në pesë nëndarje drejtkëndore të barabarta të vendosura në mënyrë të tillë që brinja gjatësore e një nëndarjeje është në kontakt me 4 brinjët anësore të katër nëndarjeve të tjera. Perimetri i kutisë është 144 cm. Cilat janë dimensionet në centimetra të një nëndarjerje?

- A) 8×32 B) 7×28 C) 6×24 D) 9×36

30) Cili prej lumenjve të mëposhtëm kalon në Paris?

- A) Tamizi B) Elba C) Sena D) Danubi

31) Nëse: Elio ka lindur përpara Françeskës, e cila ka lindur përpara Gjergjit. Gjithashtu, edhe Iliri ka lindur përpara Gjergjit. Atëherë...

- A) Është e sigurt që Elio është më i madhi.
 B) Iliri është më i vjetri në moshë.
 C) Iliri dhe Françeska kanë të njëjtën moshë.
 D) Elio dhe Françeska kanë me siguri mosha të ndryshme.

32) Vepër e kujt artisti është piktura e titulluar “Lulëzimi i pemës së bajames”, ilustruar në figurën mëposhtë?



- A) Henri Matisse
 B) Paul Gauguin
 C) Paul Cézanne
 D) Vincent van Gogh

33) Cilat nga veprat arkitektonike të mëposhtme nuk është vepër e Antoni Gaudít?

- A) Pavijoni i Barcelonës
 B) Parku Güell
 C) Shtëpia Milà
 D) Kisha “Sagrada Familia”

34) Nëse është e vërtetë që të gjithë lapsat që kam janë të kuq përveç dy prej tyre, të gjithë lapsat që kam janë blu përveç dy prej tyre, të gjithë lapsat që kam janë të zinj përveç dy prej tyre, sa lapsa kam?


- A) Dy
 B) Tre
 C) Një
 D) Katër

35) Cila nga fjalët e mëposhtme duhet vendosur në vend të pikëpyetjes?

Kama	Ajër	Nder	Alarm
Arra	Rosa	Ëndërr	Sonte
Mësim	Artist	Nëna	?

- A) Dash
 B) Irracional
 C) Ndërtues
 D) Raketë

36) Sa është sipërfaqja në m² e dhomës së paraqitur në plan referuar përmasimit të dollapit në cm?



- A) 8.1 m²
 B) 13.2 m²
 C) 14.4 m²
 D) 11.025 m²



37) Cili prej kombinimeve të mëposhtme nuk është i saktë:

- A) Petro Marko-shkrimtar B) David Selenica-piktor
 C) Ibrahim Kodra-shkrimtar D) Violeta Manushi-aktore

38) Nëse pohimi “Të gjithë atletët vrapojnë shpejt” është jo i vërtetë, atëherë detyrimisht:

- A) Të paktën një atlet nuk vrapon shpejt B) Asnjë atlet nuk vrapon shpejt
 C) Të paktën një atlet vrapon shpejt D) Të gjithë atletët vrapojnë ngadalë

39) Cila nga alternativat është paraqitja me projeksione për figurën gjeometrike të dhënë në aksonometri ?



- A) 1 B) 4 C) 2 D) 3

40) Kush është autori i veprës “Motra Tone”, ilustruar në figurën më poshtë?

- A) Alush Shima B) Vangjush Mio C) Kolë Idromeno D) Ibrahim Kodra



41) Pushtimi i Kostandinopojës nga Perandoria Osmane ndodhi në:

- A) 1744 B) 1453 C) 1590 D) 1321

42) Zgjidh alternativën, e cila rendit objektet sipas lartësisë në metra, duke filluar nga objekti me lartësi më të ulët:

- A) Piramida e madhe, Gizë; Kulla Eiffel, Paris; Ndërtesa “Empire State”, New York; One World Trade Center, New York
 B) Kulla Eiffel, Paris; Piramida e madhe, Gizë; Ndërtesa “Empire State”, New York; One World Trade Center, New York
 C) Kulla Eiffel, Paris; Piramida e madhe, Gizë; One World Trade Center, New York; Ndërtesa “Empire State”, New York
 D) Piramida e madhe, Gizë; Kulla Eiffel, Paris; One World Trade Center, New York; Ndërtesa “Empire State”, New York

43) Është dhënë trupi në aksonometri. Përcaktoni dy projeksionet që i mungojnë tek paraqitja me projeksione.



- A) V-1; W-3 B) V-2; W-4 C) V-5; W-6 D) V-3; W-4

44) Cila nga veprat e mëposhtme nuk është e Leonardo da Vinci-t?

- A) "Mona Lisa" B) "Darka e fundit"
C) "Kapela Sistine" D) "Njeriu Vitruvian"

45) Cilat shkronja duhet të zëvendësojnë pikëpyetjen?


HË	MA
MË	ENJ
PR	SHT
DI	?

- A) HË B) SHT C) MA D) DI



46) Përmasat e formatit A6 të vizatimit janë:

- A) 106 mm x 149 mm B) 105 mm x 148 mm
C) 105 mm x 149 mm D) 106 mm x 148 mm

- 47) Për të skicuar me dorë të lirë këndin e ngushtë, mbi një vijë horizontale fillojmë nga një pikë **0**, duke vendosur segmentin njësi, disa herë deri tek pika **a**. Më tej, tek pika **a** ndërtojmë një vijë vertikale duke vendosur segmentin njësi disa herë, deri tek pika **b**. Bashkojmë **0** me **b**. Këndi përballë brinjës **ab** është këndi i ngushtë i kërkuar. Për të ndërtuar këndin 60° , sa segmente njësi duhen vendosur në vijën horizontale dhe sa në vijën vertikale?



- A) 3 njësi dhe 4 njësi
 B) 3 njësi dhe 5 njësi
 C) 3 njësi dhe 6 njësi
 D) 3 njësi dhe 2 njësi
- 48) Piramida e Tiranës i është ushtruar një transformimi së fundmi duke zbatuar projektin e realizuar nga studio e mëposhtme prestigjioze e arkitekturës:
- A) MVRDV
 B) OMA
 C) Mecanoo
 D) UNStudio
- 49) Cila është kutia që mungon?



- 50) Një trup lihet të bjerë vertikalisht nga prehja nga një lartësi e caktuar dhe fiton në fund të lëvizjes një energji kinetike E . Sa bëhet energjia kinetike nëse masa e trupit dyfishohet?
- A) $E/2$
 B) $2E$
 C) E
 D) $4E$

51) Gjenerali si mund të vazhdojë sekuenca e mëposhtme:

2 — 3 — 5 — 9 — 17 — 33 — ...

- A) 56 B) 67 C) 99 D) 65

52) Regjizori i cilit prej filmave të mëposhtëm është Dhimitër Anagnosti?

- A) Koncert në vitin 1936 B) Vdekja e kalit
C) I dashur armik D) Përrallë nga e kaluara

53) Një ditë pyeta shokët se në cilin muaj do të vinte shfaqja e cirkut në qytet; ja si m'u përgjigjën secili prej tyre.

Beni: Ky muaj ka 31 ditë.

Aldo: Ky muaj ka 5 gërma.

Edi: Ky muaj ka dy shkronja njësoj.

Klea: Ky muaj mbaron me shkronjën R.

Tomi: Ky muaj ka dy zanore të ndryshme.

Ela: Ky muaj ka 30 ditë.

Nëse vetëm njëri prej tyre po gënjen: Cili është muaji në të cilin vjen cirku e që po flasin shokët?

- A) Korrik B) Janar C) Nëntor D) Tetor

54) Një klasë me 40 nxënës duhet të ndahet për një projekt në grupe të vogla me nga 3, 4 ose maksimumi 5 nxënës. Sa është numri maksimal i grupeve që mund të formohen?

- A) 11 B) 12 C) 8 D) 13

55) Cilët numra duhet të zëvendësojnë pikëpyetjet?

4	7	1
5	1	3
9	8	4

5	1	3
2	8	5
7	9	8

1	2	6
2	9	2
?	?	?

- A) 3 1 8 B) 4 1 8 C) 6 2 4 D) 5 1 4

56) Cili nga çiftet e mëposhtme të fjalëve plotëson saktë fjalinë: "Ndonëse njërihej si person, fjalimi i tij në kongres ishte shumë"?

- A) inteligjent, kritik B) i ndrojtur, i nënshtruar
C) erudit, brilant D) i drejtë, jokorrekt

57) Cili qytet ishte qendra e artit evropian në fillimet e shekullit të 20-të?

- A) Amsterdami B) Vjena C) Parisi D) Londra

58) Nga veprat e mëposhtme për zgjidh atë që nuk i përket piktorit Pablo Picasso.



A)



B)



C)



D)

59) Në cilin prej kongreseve u vendos alfabeti, me të cilin shkruhet edhe sot gjuha shqipe?



A) Kongresi i Lushnjës

B) Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe

C) Kongresi i Përmetit

D) Kongresi i Manastirit

60) Plotësoni saktë pamjen e tretë në paraqitjen me projeksione të trupit gjeometrik.




1



2



3



4

A) 4

B) 1

C) 3

D) 2

Answer Key

Testname: UNTITLED1

- 1) C
- 2) A
- 3) B
- 4) B
- 5) D
- 6) D
- 7) D
- 8) D
- 9) A
- 10) D
- 11) A
- 12) D
- 13) C
- 14) D
- 15) A
- 16) D
- 17) D
- 18) C
- 19) A
- 20) D
- 21) D
- 22) C
- 23) B
- 24) A
- 25) A
- 26) A
- 27) D
- 28) D
- 29) A
- 30) C
- 31) D
- 32) D
- 33) A
- 34) B
- 35) B
- 36) C
- 37) C
- 38) A
- 39) C
- 40) C
- 41) B
- 42) A
- 43) A
- 44) C
- 45) A
- 46) B
- 47) B
- 48) A
- 49) D
- 50) B
- 51) D
- 52) D
- 53) D
- 54) D

Answer Key

Testname: UNTITLED1

- 55) B
- 56) D
- 57) C
- 58) A
- 59) D
- 60) B